

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(Të Shoqërisë "Max Watersports" Sh.p.k)

Sot, më datë 25/09/2025, u paraqit personalisht:

BLERES: Znj.Malvina Pertafti i datelindjes 08.08.1988 , banues ne Durres, shtetas shqiptar madhor, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me karte identiteti me numer I85808060R.

SHITES: Z. Marcello Subashi, i datelindjes 23.08.1992, banues ne Durres, shtetas Shqiptar, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer J20823071A.

Të cilët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord të lidhin këtë Kontratë Të Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Max Watersports" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Kushte Paraprake të Përgjithshme

Shoqëria "Max Watersports" shpk e regjistruar në QKB me Nr. NIPTI M51424509A aktualisht me adresë: Lagjia 13, ,Rruga Shkambi I Kavajes prane Pistes Bleart, ZK 8518. me kapital 100% shqiptar e përbërë nga 2 Kuota, në të cilën 1 (një) kuotë me vlerë 51.000 pesedhjetenje mije) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë zotërohet nga Znj.Malvina Pertafti dhe 1 (një) kuotë me vlerë 49.000 dyzetente mije) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë zotërohet nga Z. Marcello Subashi

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Max Watersports shpk", me datë 25/09/2025, është vendosur:

a. *Transferimi i 1 (një) kuotë me vlerë 49 000 (Dyzetenentemijë) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Watersports" sh.p.k, që i përkasin Z. Marcello Subashi në dobi të Znj.Malvina Pertafti.*

NENI 1

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Transferimi me shitje 1 (një) kuote me vlerë 49 000 (Dyzetenente mijë) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Watersports" sh.p.k, që i përkasin Z. Marcello Subashi në dobi të blerësit Znj.Malvina Pertafti.

b.Shitësi Z. Marcello Subashi dëshiron t'ë shesë dhe transferojë te Blerësi Znj.Malvina Pertafti, 1 (një) kuotë me vlerë 49000 (Dyzetenentemijë) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Watersports" sh.p.k.

c. Blerësi Znj.Malvina Pertafti dëshiron të blejë nga Shitësi Z.Marcello Subashi 1 (një) kuotë me vlerë

c. Blerësi Znj.Malvina Pertafi dëshiron të blejë nga Shitësi Z.Marcello Subashi 1 (një) kuotë me vlerë 49000(Dyzetenentemijë) Lek pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Watersports" sh.p.k. dhe Shitësi Z.Marcello Subashi dëshiron të shesë 1 (një) kuotë me vlerë 49000(Dyzetenentemijë) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Watersports" shpk.

NENI 2

KALIMI I TITULLIT TE PRONESISE DHE POSEDIMI

Më nënshkrimin e kësaj Kontrate Znj.Malvina Pertafi do të rezultojë pronar i 1 (një) kuote me vlerë 100000 (Njeqindmijë) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Watersports" sh.p.k.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shoqëria do të ndryshojë si më poshtë:

Znj.Malvina Pertafi, do të përfaqësohet me 1 (një) kuote me vlerë 100000 (Njeqindmijë) Lekë pjesëmarrëse të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Watersports" sh.p.k.

NENI 3

DEKLARIME DHE GARANCI

Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

Shitësat deklarojnë dhe garantojnë se janë prona të ligjshëm të Pasurisë së Luajtshme identifikuar në dokumentet bashkëngjitur, titulli i pronësisë mbi të është fituar në mënyrë të ligjshme, dhe nuk kanë asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur këtë kontratë, dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj. Shitësat janë të vetmit pronar të ligjshëm të Pasurisë së identifikuar në pikën A të nenit 1, më sipër dhe ka të drejtë të lidhin këtë Kontratë e të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj.

Shitësat deklarojnë dhe garantojnë se Pasuria identifikuar në dokumentet bashkëngjitur, është e lirë nga çdo barrë apo kufizim;

Shitësat i japin Blerësit garancitë më të plota të parashikuara me ligj.

Shitësat deklarojnë dhe garantojnë Blerësin se zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi dhe përmbushja prej tyre e detyrimeve të marra përsipër nuk shkelin, çenojnë apo është janë konflikt me detyrime që Shitësat kanë marrë përsipër sipas marrëveshjeve apo kontratave me të tretë në lidhje me Pasurinë apo pjesë të saj.

Blerësi deklaron dhe garanton Shitësat se:

Kjo Kontratë përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe të ekzekutueshëm për Blerësin dhe Blerësi i ka të gjithë të drejtat të lidhë këtë Kontratë dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.

Blerësi do të paguajë të gjithë Çmimin e Shitjes sipas parashikimeve të kësaj Kontrate. Blerësi deklaron e garanton se fondet e nevojshme për blerjen e Pasurisë i ka siguruar nga biznesi i tij si person fizik. Blerësi do të përballojë të gjitha shpenzimet në lidhje me tarifat, tatimet, kostot dhe shpenzimet që lidhen me apo rezultojnë nga kalimi i pronësisë, përfshirë pa kufizim shpenzimet noteriale, merr përsipër të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë dhe në të ardhmen që shoqëria ka aktualisht.

Blerësi merr përsipër për të kryer të gjithë veprimet për depozitimin për regjistrimin e kësaj kontrate në QKB, .

Neni 4
Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

Kjo Kontrate do te zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Çdo çështje që nuk gjen rregullim në këtë Kontrate do të rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që mund të lind midis Shitësit dhe Blerësit në lidhje me këtë Kontrate dhe që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres.

Neni 5
Anekset

Kësaj kontrate i bashkëngjiten:

Ekstraktet e regjistrimit tregtar dhe dokumentet e identifikimit të Shitësit;

Formulari i regjistrimit të barreve siguruese.


Karta e Identitetit të palëve.

Dispozita Përfundimtare

Kontrata e shitjes pasuri e luajtshme – Kuota të shoqërisë u hartua në gjuhën shqipe prej meje në 3 (TRE) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese, një kopje depozitohet në institucionin e regjistrimit të pasurive të luajtshme, QKB, për t'u regjistruar dhe dy kopjet e tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

SHITESI

Marcello Subashi



BLERESI

Malvina Pertafti